

KONTRATË PËR SHITJEN E KUOTËS

Lidhur në Tiranë, sot, më 01.10.2021, ndërmjet palëve të mëposhtme:

SHITËSI: **Z.Klodian ALLAJBEU**, i biri i Fadilit, lindur në Berat, më 21.04.1978 dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, identifikuar nëpërmjet pasaportës me nr.N804211641, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar *(më tej referuar si "Shitësi")*.


BLERËSI: **Z.Denion IDRIZI**, i biri i Shpëtim dhe Enkela, lindur në Tiranë, më 07.08.1992 dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, identifikuar nëpërmjet pasaportës me nr.BC1003117 dhe nr.personal J20807057, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar *(më tej referuar si "Blerësi")*

(së bashku referuar si "Palët")

DHËNËS PËLQIMI: **1. Znj.Iris ALLAJBEU**, e bija e Petritit, lindur në Berat, më 07.09.1979, e banuese në Tiranë, shtetase shqiptare, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr.personal H95907130A, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar, përfaqësuar nëpërmjet Prokurës së Përgjithshme nr.1590 Rep., nr.788 Kol., datë 01.04.2021 nga **Z.Klodian ALLAJBEU**.

2. Shoqëria "SOLID CONSTRUCTION" SHPK, regjistruar pranë QKB me NUIS L81825002C, me seli në Tiranë, në adresën Njësia Bashkiake nr.2, Rruga e Elbasanit, Zona Kadastrale 8160, Pasuria nr.5/181, përfaqësuar nga administratorja, **Znj.Emirljana ERDEN**, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar *(më tej referuar si "Shoqëria")*.

BAZA LIGJORE: Nenet 705 e vijues të Kodit Civil (i ndryshuar), si dhe nenet 73-75 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar).



DEKLARIME PARAPRAKE

1. Palët janë ortakë në shoqërinë "SOLID CONSTRUCTION" SHPK, regjistruar pranë QKB me NUIS L81825002C, me seli në Tiranë, në adresën Njësia Bashkiake nr.2, Rruga e Elbasanit, Zona Kadastrale 8160, Pasuria nr.5/181 (më tej referuar si "Shoqëria"), ku secili prej tyre është zotërues i 1 (një) kuote, e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes prej 50% në kapitalin bazë të shoqërisë.
2. Shitësi kërkon të shesë 100% të kuotës së tij dhe Blerësi është i interesuar ta blejë atë.
3. Palët kanë dijeni se Shoqëria është në marrëdhënie huamarrje me disa shoqëri të lidhur me Shitësin. Duke qenë se me kalimin efektiv të kuotës në pronësi të Blerësit, Shitësi nuk do të jetë më pjesë e strukturës së ortakëve të Shoqërisë, Palët bien dakord që nëpërmjet kësaj Kontrate të zgjidhin dhe mënyrën se si do të kthehen vlera e huave në favor të shoqërive të lidhur me Shitësin.
4. Znj.Iris Allajbeu, bashkëshortja e Shitësit me vullnetin e saj të plotë, të lirë e të pacenuar, jep pëlqimin për shitjen e kuotës dhe për të gjitha pasojat juridike si rrjedhojë e nënshkrimit të kësaj Kontrate.
5. Shoqëria "SOLID CONSTRUCTION" SHPK me vullnetin e saj të plotë, të lirë e të pacenuar, jep pëlqimin për shitjen e kuotës dhe për pagimin e huave sipas nenit 6 të kësaj Kontrate.

Për këto arsye, Palët, me vullnetin e tyre të plotë, të lirë e të pacenuar, vendosin të lidhin këtë Kontratë për Shitjen e Kuotës që Shitësi zotëron në shoqërinë "SOLID CONSTRUCTION" SHPK (më tej referuar si "Kontrata"), me kushte si më poshtë vijon:

NENI 1


Objekti

- 1.1 Objekti i kësaj Kontrate është përcaktimi i kushteve, modaliteteve dhe pasojave të transaksionit mbi shitjen e Kuotës nga Shitësi në favor të Blerësit.

NENI 2

Çmimi dhe mënyra e pagesës

- 2.1 Kuota do të shitet në vlerë nominale dhe çmimi i shitjes së saj do të jetë 500 (pesëqind) lekë neto.
- 2.2 Çmimi është paguar nga Blerësi në favor të Shitësit *cash* në momentin e hartimit të kontratës.
- 2.3 Të gjitha pagesat lidhur me ekzekutimin dhe regjistrimin e kësaj Kontrate do të mbarten nga Shitësi, me përjashtim të komisioneve dhe tarifave për transfertën bankare të çmimit të kuotës dhe taksave/tatimeve që lidhen me shitblerjen e kuotës që mbarten nga Blerësi.



NENI 3

Kalimi i pronësisë mbi kuotën

- 3.1 Me nënshkrimin e kontratës, Blerësi bëhet pronar i 1 (një) kuote e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes me 100% në kapitalin bazë të shoqërisë.
- 3.2 Regjistrimi i Kontratës pranë institucioneve përgjegjëse (si për shembull: Qendra Kombëtare e Biznesit) do të ketë funksion deklarativ ndaj të tretëve dhe Blerësi fiton pronësinë mbi kuotën në momentin e përcaktuar në nenin 3.1 më sipër, pavarësisht momentit se kur kjo Kontratë regjistrohet dhe publikohet pranë institucioneve përgjegjëse.

NENI 4


Pasojat e shitjes së kuotës

- 4.1 Palët bien dakord se si pasojë e shitjes së kuotës, Shoqëria do të bëhet shoqëri me një ortak të vetëm, i cili do të jetë Blerësi. Ky i fundit bëhet pronar i 1 (një) kuote e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes me 100% në kapitalin bazë të shoqërisë.
- 4.2 Çdo e drejtë apo detyrim i Shitësit në lidhje me shoqërinë, i cili daton përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate do të mbetet ekskluzivisht i tij.

NENI 5

Garancitë e Palëve

- 5.1. Shitësi garanton Blerësin se:
 - 5.1.1. Zotëron 1 (një) kuotë në Shoqëri, e cila përfaqëson 50% të kapitalit të saj bazë, e cila është në vlerën 500 (pesëqind) lekë. Kuota në tërësinë e saj nuk është subjekt sekuestrimi, ndalimi shitje, të drejte parablerje, garancie bankare, apo e ndonjë mjeti tjetër i cili siguron ekzekutimin e detyrimeve; Kuota e Shoqërisë gjithashtu nuk është subjekt i barre reale apo juridike.
 - 5.1.2. Ka të drejtë, aftësi dhe zotësi të plotë për të vendosur shitjen e Kuotës dhe për të ekzekutuar këtë Kontratë sipas parashikimeve të saj, pa patur nevojën për pëlqimin apo miratimin paraprak të ndonjë personi tjetër, qoftë ky fizik apo juridik;
 - 5.1.3. Ka ndërmarrë apo do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme juridike për autorizimin, ekzekutimin dhe regjistrimin e kësaj Kontrate.
 - 5.1.4. Përmbushja e kësaj kontrate nuk do të rezultojë në situatë kundërligjshmërie, paligjshmërie apo pavlefshmërie, lidhur me Kontratën në vetvete, Statutin e Shoqërisë, marrëdhënie detyrimesh mes shoqërisë dhe të tretëve apo Shitësit dhe të tretëve, ose me legjislacionin në fuqi;
 - 5.1.5. Asnjë person i tretë fizik ose juridik nuk ka të drejta mbi kuotën apo kapitalin e Shoqërisë.
- 5.2. Blerësi garanton Shitësin se:
 - 5.2.1. Blerja e 1 kuote e cila përfaqëson 50% të kapitalit të bazë të Shoqërisë, e zotëruar nga Shitësi është në përputhje me vullnetin e tij;



- 5.2.2. Ka të drejtë, aftësi dhe zotësi të plotë për të vendosur blerjen e Kuotës dhe për të ekzekutuar këtë Kontratë sipas parashikimeve të saj, pa patur nevojën për pëlqimin apo miratimin paraprak të ndonjë personi tjetër, qoftë ky fizik apo juridik;
- 5.2.3. Ka ndërmarrë apo do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme juridike për autorizimin, ekzekutimin dhe regjistrimin e kësaj Kontrate;
- 5.2.4. Përbushja e kësaj kontrate nuk do të rezultojë në situatë kundërligjshmërie, paligjshmërie apo pavlefshmërie, lidhur me Kontratën në vetvete, marrëdhënie detyrimesh mes Blerësit dhe të tretëve, ose me legjislacionin në fuqi;
- 5.2.5. Vlera monetare e përdorur për blerjen e kuotës sipas kontrate është krijuar si pasojë e veprimtarisë së ligjshme.
- 5.2.6. Blerësi nuk është subjekt i ndonjë procesi penal lidhur me veprimtarinë e tij;
- 5.2.7. Është në dijeni dhe ka miratuar huatë që ka marrë Shoqëria nga persona të tretë juridikë të lidhur me Shitësin.

NENI 6

Pagimi i huave

- 6.1. Blerësi merr përsipër që të sigurohet dhe të kryejë çdo veprim të nevojshëm në cilësinë e ortakut të vetëm të Shoqërisë me qëllim realizimin e kthimit të vlerave të huasë nga Shoqëria në favor të personave të tretë juridikë të lidhur me Shitësin, referuar në pikën 3 të "Deklarimeve Paraprake", sipas parashikimeve të nenit 6.2 më poshtë.
- 6.2. Brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate, Shoqëria do t'i paguajë personave të tretë të lidhur me Shitësin vlerat respektive të huave duke i shitur atyre sipërfaqe ndërtimore në kosto në raport me vlerat respektive të huasë. Shitja do të kryhet nëpërmjet kontratës për premtimin e shitjes (ose kontratës për shitjen e sendit të ardhshëm), ku Shoqëria do të ketë cilësinë e Shitësit dhe secili nga huamarrësit cilësinë e Blerësit. Çmimi do të paguhet nëpërmjet kompensimit të detyrimeve ose nëpërmjet cedimit të kredive respektive të palëve kontraktore në favor të njëra-tjetrës.

NENI 7

Konfidencialiteti

- 7.1. Palët bien dakord që kjo Kontratë dhe çdo negociim parakontraktor do të trajtohen në përputhje me parimin e konfidencialitetit dhe se nuk do të transmetojë asnjë të dhënë apo informacion lidhur me marrëdhëniet tregtare, financiare apo ligjore të njëra-tjetrës, si dhe se nuk do të bëjnë asnjë deklaratë lidhur me ekzistencën, objektin apo parashikimet e kësaj Kontrate.
- 7.2. Palët përjashtohen nga detyrimi i ruajtjes së konfidencialitetit në rast se:

7.2.1. Pala tjetër ka dhënë pëlqimin për transmetimin e të dhënave;

7.2.2. Transmetimi bëhet në kuadër të përbushjes së një detyrimi;



- 7.2.3. Transmetimi i bëhet një këshilltari të shoqërisë, i cili është subjekt i detyrimit të ruajtjes së konfidencialitetit (p.sh. Avokatit, ekspertit kontabël);
- 7.2.4. Nevojitet për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një kompetence të Palës që transmeton informacionin ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat;
- 7.2.5. Nevojitet për ndjekjen e interesave legjitimë të palës që transmeton informacionin ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat;
- 7.2.6. Këto të dhëna janë bërë publike nga vetë pala tjetër dhe ndodhen në domain-in publik dhe/ose janë të aksesueshme nga persona të tretë;
- 7.2.7. Këto të dhëna janë bërë publike ose i janë bërë të njohura palës që transmeton të dhënat nga persona të tretë.

NENI 8


Komunikimi ndërmjet palëve

- 8.1. Të gjitha komunikimet ndërmjet palëve, si dhe kërkesat që ato kanë ndaj njëra tjetrës, do të kryhen në mënyrë shkresore ose nëpërmjet e-mail-it, në adresat dhe e-maillet e përcaktuara nga palët në pjesën e gjeneraliteteve të tyre.
- 8.2. Në rast se personat dhe/ose adresat dhe/ose e-mail-et e mësipërme pësojnë ndryshime, Pala që i pëson ato ka detyrimin të njoftojë palën tjetër brenda 24 orësh nga momenti i ndryshimit. Në rast të kundërt, çdo komunikim në adresën e mëparshme do të konsiderohet i vlefshëm edhe pse mund të mos jetë marrë nga ana e Palës që ka ndryshuar personin e kontaktit dhe/ose adresën dhe/ose e-mail-in.
- 8.3. Çdo komunikim ndërmjet palëve është konfidencial dhe nuk mund t'i transmetohet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë personave të tretë me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 7.2 i kësaj Kontrate.

NENI 9

Zgjidhja e kontratës

- 9.1. Mospërbushja e detyrimeve të parashikuara në nenin 6 të kësaj Kontrate passjell automatikisht zgjidhjen e saj. Zgjidhja i njoftohet Blerësit nga Shitësi me një njoftim të thjeshtë në selinë e Shoqërisë. Zgjidhja konsiderohet e konsumuar me marrjen e njoftimit dhe hyn në fuqi menjëherë, pa nevojën e një marrëveshje të re mes palëve dhe/ose konstatimit gjyqësor të saj. Në këtë rast, Palët kthehen automatikisht në gjendjen e mëparshme dhe Blerësi autorizon në mënyrë të pakushtëzuar Shitësin për regjistrimin e pronësisë së tij mbi 1 (një) kuotë e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes prej 50% në kapitalin bazë të shoqërisë.
- 9.2. Palët bien dakord se nuk do ta zgjidhin kontratën për asnjë shkak tjetër të ndryshëm nga ai i parashikuar në nenin 9.1 më sipër.



NENI 10

Interpretimi i kontratës

- 10.1. Kushtet e përcaktuara në këtë kontratë interpretohen pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, por duke pasur parasysh qëllimin e vërtetë të palëve, që i ka shtyrë për nënshkrimin e këtij akti. Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit. Në rast dyshimi, kontrata ose kushtet e saj interpretohen në kuptimin në të cilin mund të kenë ndonjë efekt dhe jo në atë, sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt.
- 10.2. Ligji i zbatueshëm për interpretimin e kësaj Kontrate do të jetë legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, e më specifiku, nenet 705 e vijues të Kodit Civil (i ndryshuar), si dhe nenet 73-75 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar).

NENI 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 11.1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Palëve lidhur me këtë Kontratë, palët duhet të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim.
- 11.2. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, Kontrata do të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor dhe kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 12

Forca madhore

- 12.1. Për qëllim të kësaj kontrate, "Forcë Madhore" nënkupton një ngjarje që nuk shkaktohet dhe është përtej kontrollit të arsyeshëm të një prej palëve të kësaj Kontrate, e cila shkakton që përmbushja të detyrimeve të palës në këtë kontratë të bëhet ose e pamundur, ose aq jopraktike sa, në mënyrë të arsyeshme, të konsiderohet e pamundur duke pasur parasysh rrethanat. Ajo përfshin ndër të tjera, epidemitë, pandemitë, gjendjet e fatkeqësisë natyrore, luftën, mosbindjen civile, stuhitë, përmbytjet ose grevat.
- 12.2. Në rastet e ekzistencës së kushteve të Forcës Madhore, afatet e parashikuara në të këtë kontratë për ekzekutimin e detyrimeve mund të shtyhen nëse është e nevojshme për aq kohë sa zgjat Forca Madhore. Forca Madhore nuk përfshin pamjaftueshmërinë e fondeve ose moskryerjen e një pagese që duhet kryer sipas kontratës.


NENI 13

Të tjera

- 13.1. Bashkëlidhur dhe pjesë integrale e kësaj Kontrate janë:


13.1.1. Kopje e letërnjoftimit të palëve nënshkruese;

13.1.2. Ekstrakt nga regjistri tregtar i Shoqërisë;




- 13.1.3. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë, datë 27.09.2021.
- 13.2. Çdo ndryshim i kësaj Kontrate bëhet me pëlqimin e përbashkët të palëve dhe do të jetë i vlefshëm vetëm në rast se bëhet me shkrim.
- 13.3. Kjo kontratë përbëhet nga 7 (shtatë) faqe dhe është hartuar në 5 (pesë) kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga një për secilën palë dhe një për tu regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 13.4. Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj.

SHITËSI:




Z. Klodian ALLAJBEU

BLERËSI:




Z. Denion IDRIZI

DHËNËS PËLQIMI:



Znj. Iris ALLAJBEU

Përfaqësuar me prokurë nga Z. Klodian ALLAJBEU



Shoqëria "SOLID CONSTRUCTION" SHPK

Përfaqësuar nga administratorja, Znj. Emirljana ERDEN

SOLID CONSTRUCTION
S.H.P.K.
NUM: LB1825002C
TIRANË - ALBANIA